



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOLEGJI UNIVERSITAR "REALD"  
SENATI AKADEMIK

Nr. 243 Prot.

Vlorë më 20.03.2019

V E N D I M

Nr. 01, datë 20.03.2019

**"Për miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve për vitin akademik 2020 – 2021, në Kolegjin Universitar "Reald"**

Bazuar në nenin 37 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; në nenet 98 e 99 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë"; në nenin 9, pika 2, gërma "f", të Statutit të Kolegjit Universitar "Reald", miratuar me Urdhër nr. 147, datë 13.03.2017 të ministrit të Arsimit dhe Sportit;

Senati Akademik në Kolegjin Universitar "Reald"

V E N D O S I :

1. Të miratojë "Kriteret e pranimit të studentëve për vitin akademik 2020 – 2021", në Kolegjin Universitar "Reald", si më poshtë:
  - a. Në programet profesionale të studimit 2 (dy) vjeçar, kriter i pranimit është përfundimi i shkollës së mesme.
  - b. Në ciklin e parë të studimeve "Bachelor", në të gjitha programet, kriter i pranimit është nota mesatare e shkollës së mesme jo më pak se 6 (gjashtë).
  - c. Në programet e integruara të ciklit të dytë "Master i shkencave" në "Farmaci", si dhe "Master i shkencave" në "Stomatologji dhe Proteza Dentare", kriter i pranimit është nota mesatare e shkollës së mesme jo më pak se 6 (gjashtë).
  - d. Në ciklin e dytë të studimeve "Master profesional" dhe "Master i shkencave", kriter i pranimit është përfundimi i ciklit të parë të studimeve "Bachelor" në të njëjtën degë ose në një degë tjetër të përfaqësuar.